

## KLSH FTON STUDENTË TË INTERESUAR TË APLIKOJNË PËR T’U BËRË PJESE E PROGRAMIT TË INTERNSHIPIT 2018.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është Institucioni Suprem i Auditimit në Republikën e Shqipërisë. Auditimi i jashtëm publik është i rregulluar përmes ligjit 154/2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”. Si një institucion në modernizim e sipër, KLSH, do të hapë dyert për 12 praktikantë të cilët do të zhvillojnë pranë këtij institucioni praktikën mësimore (internship) 6-mujore, sipas modeleve anglo-saksone të marrëdhënies së para-punësimit, Universitet – Institucion Publik. Ky mësim i nxjerrë nga eksperiencia e vendeve më të zhvilluara do të aplikohet në KLSH me qëllim ndihmesën e brezit të ri të studentëve më të përgatitur përpara një tregu pune dinamik, sfidues dhe të ngushtë.

Praktika do të zgjasë gjashtë muaj dhe do të zhvillohet në periudhat 20 prill 2018 – 30 korrik 2018 dhe 1 shtator 2018 – 15 nëntor 2018. Duke mundësuar që muaji gusht të jetë pushim për praktikantët. Praktikantët do të punojnë PA PAGESË pranë departamentit ku do të caktohen. Ndarja e 10 praktikantëve në departamente të ndryshme do të bëhet në një ekuilibër midis nevojave të institucionit dhe preferencës së tyre. Praktikantët do të kenë mundësi të punojnë dhe marrin eksperiencë të dorës së parë gjatë aktivitetit të tyre të përditshëm në KLSH. Në marrëveshje me eprorin ku do të caktohen, praktikantët mund të punojnë 3 – 6 orë çdo ditë. Secila prej palëve, KLSH apo studenti praktikant, mund të mbyllin bashkëpunimin para kohe, me një njoftim me shkrim një ditë pune përpara.

### **Aktivitetet e parashikuara:**

Praktikantët pranë KLSH do të ndihmojnë me punë kërkimore dhe mbështetëse pranë Drejtorive të KLSH. Praktikantët pasi të ndahen në departamente do të marrin detyrat e përditshme nga eprori i tyre direkt në bazë ditore ose javore. Praktikantët duhet të tregojnë frymë të lartë integriteti gjatë kohës së punës Brenda dhe jashtë KLSH. Praktikantët me pranimin e pjesëmarrjes në programin e internshipit do të nënshkruajnë një marrëveshje ku bien dakord për një sërë rregullash për mbarëvajtjen e praktikës. KLSH ofron të ndihmojë praktikantët me dokumentet e nevojshme që vërtetojnë periudhën e praktikës, detyrat e ngarkuara, si dhe një vlerësim në fund të praktikës.

### **Përgjegjësitë:**

- ❖ Mbështetje të Drejtorive me punë kërkimore, sipas nevojës;
- ❖ Përgatitje e shkresave të nevojshme për Drejtorin e Departamentit;
- ❖ Ndjekje e zhvillimeve institucionale si takime, konferenca, lajme etj;
- ❖ Përgatitje, përkthime, redaktim dhe kontribut në publikimet e KLSH;
- ❖ Menaxhim i marrëdhënieve të KLSH-së me mediat sociale;
- ❖ Mbështetje administrative, sipas nevojës.

### **Kualifikimet e nevojshme:**

Interes në Auditimi, Financa publike, Ekonomi, Ekonomi Politike, Analizë Ekonomike, Mjedis, Ligj, Shkenca Politike e Marrëdhënie Ndërkombëtare, etj.

Interes dhe/ose përvojë komunikimi me publikun dhe mediat (mediat sociale).

Njohje shumë e mirë e gjuhës shqipe dhe angleze; vlerësohen dhe njohuri të gjuhëve të huaja të tjera.

- Aftësi shumë të mira kompjuterike: Word, Exel, PPT, IDEA, etj.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për t'iu përgjigjur shpejt udhëzimeve.
- Aftësi për të kryer punë kërkimore, dhe shkrimin e raporteve.
- Vlerësohen aftësitë në menaxhim dhe multitasking (disa detyra paralelisht).

Mund të aplikojë çdo student i cili është në përfundim të ciklit BA. Preferencë për studentë që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve universitare BA, ose që kanë përfunduar studimet pasuniversitare master jo më larg se viti 2017.

12 më të mirët do të përzgjidhen duke u bazuar mbi nevojat e institucionit dhe kriteret si:

- aftësitë e tyre të komunikimit;
- performance e tyre në shkollë (nota mesatare mbi 8);
- aktivizimi i tyre qytetar në çështje të interesit publik;
- Punësime apo internship të mëparshme;
- Gatishmëria e tyre për të ndjekur të plotë programin.

Për të aplikuar ju duhet të dërgoni me email: a) CV në formatin Europass; b) Letër motivimi ose rekomandim nga një pedagog, në adresën [bkotorri@klsh.org.al](mailto:bkotorri@klsh.org.al).

Pas përzgjedhjes, do të njoftohen për fazën e intervistës (20 prill 2018), vetëm 25 aplikantët e suksesshëm prej të cilëve do të përzgjidhen 12 fituesit.

**Afati për dorëzimin e aplikimeve është data 15 prill 2018.**